

V E N D I M
Nr. 476, datë 19.7.2001

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”,
NDRYSHUAR ME VENDIMET NR.39, DATË 26.1.2001. NR.158, DATË 22.3.2001. NR.167,
DATË 30.3.2001, NR.174, DATË 30.3.2001, NR.197, DATË 6.4.2001, NR.385, DATË 31.5.2001
DHE NR.424, DATË 11.6.2001, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 2 dhe 6 të ligjit 8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për përcaktimin e pagave të punës” dhe të nenit 17 të ligjit nr.8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës” të ndryshuar me ligjin nr.8335 datë 23.4.1998, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I

Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, ndryshuar me vendimet nr.39, datë 26.1.2001, nr.158, datë 22.3.2001, nr.167, datë 30.3.2001, nr.174, datë 30.3.2001, nr.197, datë 6.4.2001. nr.385, datë 31.5.2001 dhe nr.424, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në lidhjen 1, “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit”, në klasifikimin B3 shtohet funksioni “Kryeinspektor i policisë së bashkisë së Tiranës”, dhe në klasifikimin B5 shtohet funksioni “Inspektor i policisë së bashkisë së Tiranës”.

2. Në lidhjen II-17, “Niveli i pagës për punonjësit e bashkisë së Tiranës” pas emërimit “Për njësitë bashkiake të Tiranës”, shtohet emërtimi “Për policinë e bashkisë së Tiranës”, me këtë përmbajtje:

Kryeinspektor B3
Inspektor B5
Policë Klasa XII, Lidhjes II

3. Në lidhjen II-A, “Shtesat mbi pagë për funksione drejtuese”, kreu II, “Shtesa të tjera”, pas pikës 25 shtohet pika 26, me këtë përmbajtje:

“26. Punonjësit e policisë së bashkisë së Tiranës përfitojnë shtesë page për vështirësi si më poshtë:

Kryeinspektor 10%
Inspektor 20%
Policë 80%

4. Në strukturën e aparatit të bashkisë së Tiranës shtohen 30 punonjës, dhe konkretisht:

Kryeinspektor 1
Inspektorë 5
Policë 24
Gjithsej 30

5. Efektet financiare për pagat, sigurimet shoqërore, shpenzimet operative, për veshmbathje dhe pajisjen e punonjësve të pikës 2 të këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2001, miratuar për bashkinë e Tiranës.

6. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik, Ministria e Pushtetit Lokal dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta